



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1096/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Lirije Dema nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1096/2021 i datës 08.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Lirije Dema nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 0706D/01R, 0706D/02R, 0706D/03R, 0706D/04R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 08.11.2021 të dërguar nëpërmjet Postës së Kosovës me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kaçanikut Lirije Dema nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, me të cilën dyshon se gjate numërimit të votave i është prekur vota pasi që në vendvotimin në këtë shkollë ka familjar si nga ana e saj ashtu edhe nga ana e burrit dhe nuk u janë përshkruar votat që i kanë e dalur, andaj e njëjta kërkon që të behet rinumërimi edhe njëherë pasi që ka dyshime se i janë vjedhur votat në vendvotime 0706D/01R, 0706D/02R, 0706D/03R, 0706D/04R. Si dëshmi ka bashkangjitur një deklaratë të një personi për të cilët pretendon se e ka votuar për të.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazës së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në

kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidaten në fjalë, për faktin se thëniet e saja janë vetëm theksime ne apel pa mbështetje ne ndonjë prove konkrete, si te tilla pretendimet nuk janë te bazuara dhe bindëse për të cilën ajo pretendon se ka mungesë të votave por vetëm në mënyrë të përgjithshme thekson se ka mungesë të votave.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Lirije Dema nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në vota për vendvotimet e lartcekura.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.1096/2021 më datën 09.11.2021**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.